



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 nënparagrafi 8.1.2 të Rregullave (F03) për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteteve kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “H&B Consulting” Sh.P.K. të datës 06.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest” me nr. të prokurimit 616-22-14667-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 219 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “H&B Consulting” Sh.P.K. e datës 06.02.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 29.12.2022 të korigjuar me datë 07.02.2023 pa u përgjigjur paraprakisht në kërkesën për sqarime shtesë të parashtruar nga operatori ekonomik me datë 13.01.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest” me nr. të prokurimit 616-22-14667-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 219 211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që brenda afatit prej një (1) dite kalendarike nga data kur është njoftuar me këtë vendim, të kthej përgjigje në kërkesën për informacione shtesë sipas pikës I të këtij vendimi.
- III. **DETYROHET** Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës që t’i publikoj përgjigjet sipas pikës II të këtij vendimi së bashku me korigjimin përmes të cilit duhet të bëj zgjatjen afatit për dorëzimin e ofertave për së paku edhe dhjetë (10) ditë shtesë.
- IV. **NJOFTOHET** menjëherë operatori ekonomik “H&B Consulting” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim, përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "H&B Consulting" Sh.P.K. (tutje si "parashtruesi") me datë 06.02.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 29.12.2022 të korigjuar me datë 07.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest" me nr. të prokurimit 616-22-14667-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 219 211. Pretendimi i parashtruesit është se ky njoftim për kontratë është bërë pa u përgjigjur paraprakisht në kërkesën për sqarime shtesë të parashtruar nga operatori ekonomik me datë 13.01.2023.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 20.02.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim. Me këtë rast është gjetur se "autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 07.02.2023 ka korigjuar njoftimin për kontratë të datës 29.12.2022 ashtu që ka bërë zgjatjen e afatit për hapjen e ofertave deri me datë 27.02.2023. Paraprakisht me datë 13.01.2023 operatori ekonomik kishte parashtruar kërkesë për sqarime shtesë lidhur me këtë procedurë të prokurimit. Megjithatë autoriteti kontraktues nuk kishte arritur asnjëherë që të përgjigjet në kërkesën e operatorit ekonomik të datës 13.01.2023 për sqarime shtesë. Në këtë mënyrë operatori ekonomik nuk ka arritur që të dorëzoj ofertën e vet brenda afatit përkatës". Rrjedhimisht autoriteti kontraktues përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka konstatuar se pretendimi i operatorit ekonomik sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 06.02.2023 është e argumentuar mjaftueshëm dhe si e tillë është e bazuar.

Në përputhje me të gjeturat më sipër, autoriteti kontraktues duke u bazuar te Ligji në fuqi për Prokurimin Publik (nenin 7, *et.al*) si dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (A01), duhet të bëj korigjimin e procedurës përmes njoftimit për korigjim ashtu që të bëj edhe vazhdimin e afatit për dorëzimin e ofertave në mënyrë në mjaftueshme për të gjithë operatorët ekonomik për korigjimin dhe përgatitjen e dosjes së tenderit.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.02.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.